BalkanWeb GAZETA SHQIPTARE

BW FLASH NEWS

COVID / MOH FIGURES CONFIRM CONFIRM: 8 LOSS OF LIFE AND 538 NEW CASES IN THE LAST 24 HOURS



# "Fundjava", cocaine and weapons in Tirana, 10 people are arrested

26 May, 2019 12:51 | 1 browsing




Text size:

Tirana Police has finalized today the operation "Fundjava" with surprise checks throughout the capital for the arrest of wanted persons, those who circulate with firearms or who try to distribute narcotics.

During the checks, a person who was circulating with firearms was caught, an owner of a nightclub was arrested in flagrante delicto after distributing cocaine in the bar to customers, and 8 citizens were arrested and detained in search of various criminal offenses.




Police also seized "Pistol" firearms with bullets, 11 doses of Cocaine, a vehicle and 10 mobile phones.

The operation was attended by: Narcotics Investigation Section, "Eagles",

Commissariats.

**NJOFTIMI I PLOTE**

Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në zbatim të Planit të masave për rritjen e parametrave të sigurisë, për parandalimin e ngjarjeve kriminale, kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri apo tentojnë të shpërndajnë lëndë narkotike, si dhe për kapjen e personave të shpallur në kërkim është organizuar dhe finalizuar operacioni policor i koduar "Fundjava".

Si rezultat i operacionit tek Sheshi 'Nënë Tereza', nga kontrrolli i ushtruar nga Forcat "Shigjeta", në një çantë dore brenda në automjet, në pronësi të drejtuesit të automjetit shtetasit A.Z, 26 vjeç, banues në Tiranë, është gjetur një armë zjarri pistoletë, e markës "Glock", pa leje. Në përfundim të veprimeve drejtuesi i automjetit është arrestuar në flagrancë për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".

-Nga ana e Patrullave të Përgjithshme dhe Specialistëve për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Nr.1, Tiranë, është bërë kapja dhe ndalimi i personave :

D. R., 45 vjeç banues në Tiranë

G.M.,38 vjeç, banues në Rrëshen, Mirditë, të shpallur në kërkim për veprat penale '’Plagoje e rëndë me dashje e kryer në bashkëpunim‘’ dhe "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit". Këta shtetas,

Tiranë, kanë qëlluar me armë zjarri në ajër dhe më pas kanë goditur me sende të forta në kokë dhe trup, duke e plagosur rëndë shtetasin G. H.

Po në vijim të operacionit në orët e para të mëngjezit, nga kontrolli i kryer në ambientet e lokalit me pronar dhe menaxher shtetasin Sh.I, Specialistët për Hetimin e Narkotikëve gjetën në banak të fshehura 11 doza të dyshuara me lëndë narkotike kokainë të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale së bashku me dy telefona celular dhe një automjet. Në përfundim të veprimeve u arrestua në flagrancë për veprat penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike" dhe "Përshtatje e lokalit për përdorim droge", i shtetasi :

Sh. I., 45 vjeç, banues në Kamëz Tiranë ,( pronar dhe menaxher i lokalit), i dënuar më parë për veprën penale të "Mashtrimit". Si dhe u proceduan penalisht në gjendje të lirë për veprën penale "Moskallëzim krimi", shtetasi F. G., dhe shtetasja D.K.

Gjithashtu po gjatë kontrolleve nga Patrullat e Përgjithsme të Komisariateve të Policisë Tiranë u kapën dhe u ndaluan edhe 6 shtetas të tjerë të shpallur në kërkim për vepra të ndryshme penale, konkretisht shtetasit:

I.M., për veprën penale "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve",

A S, për veprën penale "Dhuna në familje",

R K, për veprën penale "Keqtrajtim i të miturit",

Sh.K. për veprën penale "Vjedhja",

A.K., për veprën penale "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike".

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

**Etiketa:** Fundajva operacioni

## TË NGJASHME



**Vrasja e Klodian Rashës, flet ish-kreu i Policisë së Shtetit: Pati tentativë për ta manipuluar ngjarjen, SHÇBA duhet të hetojë për...**

19 Dhjetor, 2020



**Vendimi i gjykatës merr formë të prerë/ Ish-kryebashkiaku i Shkodrës, Valdrin Pjetri del i pastër nga hetimet**

19 Dhjetor, 2020

## TË FUNDIT NGA -KRONIKË



**(VIDEO) Merr flakë banesa dy katëshe në Malin e Robit, ndërhyjnë zjarrfikëset, por...**

**Klement Baçi** | 19 Dhjetor, 2020

**Ra në kontakt me rrymën elektrike, ndërron jetë 45-vjeçari në Tiranë, po punonte në një pallat në ndërtim**